



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Nr. 6637 / Prot.

Kamëz, më 31. 7. 2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore”; në Ligjin nr.48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, institucion në varësi të Bashkisë Kamëz, shpall 2 (dy) vende vakante për pozicionin Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme (Ndihmës Edukatore) pranë Kopshtit nr.21 “Univers” Laknas, Bashkia Kamëz .

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale, në momentin që aplikanti shpallet fitues:

1. CV
2. Vërtetim banimi
3. Çertifikatë personale dhe familjare
4. Dëftesë/ Diplomë + listë notash (kopje të noterizuara)
5. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)
6. Librezë pune origjinale
7. Raport mjeko – ligjor
8. Dëshmi penaliteti (deri në momentin e paisjes me dëshmi penaliteti, fotokopje të kuponit të aplikimit në postë)
9. Vërtetim gjykatë
10. Vërtetim Prokurorie
11. Vërtetimin nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi

Disa nga detyrat që duhet të kryejë Ndihmës Edukatorja janë:

1. Zbaton detyrat dhe udhëzimet që i jep Drejtuesi i kopshtit dhe edukatorja
2. Kujdeset për ngrohjen e mjediseve të ndenjes së fëmijëve.
3. Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme të institucionit .

Për pozicionin e punës si Ndihmës Edukatore në Kopsht, duhen plotësuar kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsimin e mesëm
- Të ketë eksperiencë pune me grupmoshat e përcaktuara në kopsht.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Dorëzimi i dokumentacionit do të kryhet me postë për Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,
në Bashkinë Kamëz Brenda dates 15.08.2025

 **DREJTOR**
Aferdita Zefi



Romina Kozli